



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Dega në Prizren

Zyra për Sigurim të Cilësisë

**RAPORTI PËRMBLEDHËS I REZULTATEVE TË VLERËSIMIT
NGA ALUMNI**

Kolegji Biznesi - Dega Prizren

Viti akademik 2023/24

1. Hyrje

Sigurimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë është një element kyç për zhvillimin dhe rritjen e performancës në arsimin e lartë. Kolegji Biznesi, që nga themelimi i tij në vitin 2004, ka ndërtuar një sistem të brendshëm të sigurimit të cilësisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, Standardet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë (ESG) dhe standardet e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës. Ky sistem koordinohet nga Zyra për Sigurim të Cilësisë (ZSC), e cila vepron si njësi e pavarur dhe raporton drejtpërdrejt te Dekani.

ZSC është përgjegjëse për planifikimin, zbatimin dhe analizimin e proceseve të vlerësimit të brendshëm, ndërsa gjetjet dhe rekomandimet u përcillen strukturave përkatëse për përmirësim të vazhdueshëm dhe vendimmarrje strategjike. Raporti i Alumnit përbën një komponent të rëndësishëm të këtij sistemi, pasi ofron vlerësim retrospektiv mbi përvojën akademike dhe profesionale të të diplomuarve, si dhe mbi relevancën e programeve studimore për tregun e punës.

Pyetëtori me alumnit është realizuar në mënyrë anonime gjatë vitit akademik 2023/24 në Prizren, me pjesëmarrjen e 8 respondentëve. Të dhënat janë mbledhur dhe analizuar nga Zyra për Sigurim të Cilësisë, në përputhje me parimet e transparencës dhe etikës akademike. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti shërbejnë si bazë për përmirësimin e mëtejshëm të programeve studimore dhe forcimin e kulturës së cilësisë në Kolegjin Biznesi.

2. Realizimi i pyetëtorit


Pyetëtori me Alumnin realizohet një herë në vit në koordinim me njësitë akademike të Kolegjit Biznesi në Prizren, përmes koordinatorëve për sigurim të cilësisë. Procesi zhvillohet sipas procedurave të brendshme dhe standardeve institucionale për sigurimin e cilësisë. Në ciklin e vlerësimit të vitit akademik 2023/24, pyetëtori u realizua në formë elektronike dhe anonime, me pjesëmarrjen e 8 alumnive nga programet Banka dhe Financa dhe Biznes.

Qëllimi i pyetëtorit ishte mbledhja e të dhënave të strukturuar mbi përvojën akademike, përgatitjen për tregun e punës dhe relevancën e programeve studimore. Të dhënat janë administruar dhe ruajtur nga Zyra për Sigurim të Cilësisë, në përputhje me parimet e etikës akademike, konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Gjetjet e pyetëtorit:

1.STUDIMET MË PËRGATITËN MIRË PËR KARRIERËN TIME AKTUALE (8 RESPONENT)


■ Nuk pajtohem ■ Pajtohem pjesërisht ■ Nuk e di ■ Pajtohem ■ Pajtohem plotësisht



Analiza e rezultateve tregon se vlerësimet pozitive nga alumnit dominojnë, duke reflektuar një përvojë akademike përgjithësisht të kënaqshme. Vlerësimet e pakta neutrale dhe negative paraqesin sinjale konstruktive për identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim në kuadër të sigurimit të vazhdueshëm të cilësisë.

2.STUDIMET ME MESUAN SI TE FITOJA AFTESI DHE NJOHURI TE REJA NE MENYRE TE PAVARUR (8 RESPONENT)


■ Nuk pajtohem ■ Pajtohem pjesërisht ■ Nuk e di ■ Pajtohem ■ Pajtohem plotësisht



Shumica e alumneve vlerësojnë pozitivisht zhvillimin e aftësive për të nxënë në mënyrë të pavarur gjatë studimeve, duke reflektuar një nivel të kënaqshëm të nxitjes së autonomisë akademike. Megjithatë, prania e disa vlerësimeve të moderuara dhe kritike tregon se ekziston ende nevoja për forcim të mëtejshëm të këtij aspekti, përmes metodave mësimore që inkurajojnë më shumë të nxënëit aktiv dhe vetë-menaxhimin e procesit të të nxënit.

3. UNE MUNDE TE APLIKOJ NE PUNEN TIME SHKATHTESIT TEORIKE DHE PRAKTIKE QE KAM FITUAR GJATE STUDIMEVE (8 RESPONDENT)


■ Nuk pajtohem ■ Pajtohem pjesërisht ■ Nuk e di ■ Pajtohem ■ Pajtohem plotësisht



Shumica e alumnive vlerësojnë pozitivisht aplikueshmërinë praktike të njohurive dhe shkathtësive të fituara gjatë studimeve, duke reflektuar një nivel të kënaqshëm të përgatitjes për tregun e punës. Megjithatë, prania e disa vlerësimeve të pjesshme dhe kritike tregon nevojën për forcimin e mëtejshëm të komponentës praktike të programeve studimore dhe përmirësimin e ndërlidhjes së tyre me kërkesat e tregut të punës.

4. PLAN PROGRAMI I STUDIMEVE KA OFRUAR MUNDESI ZGJEDHJEJE TE LENDEVE ZGJEDHORE QE TASH ME DUHEN DREJTPERDREJTE NE PUNE (8 RESPONDENT)


■ Nuk pajtohem ■ Pajtohem pjesërisht ■ Nuk e di ■ Pajtohem ■ Pajtohem plotësisht



Alumnit shprehin një vlerësim kryesisht shumë pozitiv për relevancën e lëndëve zgjedhore dhe përputhshmërinë e tyre me nevojat profesionale. Vetëm disa vlerësime tregojnë rezervë ose paqartësi, duke treguar nevojën për rishikim dhe përditësim të vazhdueshëm të ofertës së lëndëve zgjedhore, në përputhje me ndryshimet dhe kërkesat e tregut të punës.

5. STUDIMET ME PERGADITEN TE MENDOJ NE MENYRE ANALITIKE DHE LOGJIKE (8 RESPONENT)


■ Nuk pajtohem ■ Pajtohem pjesërisht ■ Nuk e di ■ Pajtohem ■ Pajtohem plotësisht



Rezultatet tregojnë një vlerësim përgjithësisht pozitiv të alumnive për relevancën e lëndëve zgjedhore dhe përputhjen e tyre me nevojat profesionale, me një numër të konsiderueshëm respondentësh që janë shprehur pajtohem ose pajtohem plotësisht. Megjithatë, prania e disa vlerësimeve pajtohem pjesërisht, nuk e di, si dhe një vlerësim negativ, tregon nevojën për rishikim të vazhdueshëm dhe përmirësim të ofertës së lëndëve zgjedhore, në mënyrë që ajo të përshtatet më mirë me kërkesat dinamike të tregut të punës.

6. GJAT STUDIMEVE KAM FITUAR NJOHURI TË THELLA NË FUSHËN TIME TË STUDIMEVE (8 RESPONENT)


■ Nuk pajtohem ■ Pajtohem pjesërisht ■ Nuk e di ■ Pajtohem ■ Pajtohem plotësisht



Rezultatet tregojnë se alumnit vlerësojnë në nivel të lartë zhvillimin e aftësive analitike dhe logjike gjatë studimeve, me shumicën e respondentëve që janë shprehur pajtohem plotësisht ose pajtohem. Mungesa e vlerësimeve negative dhe prania e disa vlerësimeve pajtohem pjesërisht dhe nuk e di tregojnë nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të qasjes pedagogjike, me qëllim forcimin e mëtejshëm të këtyre aftësive.

**7. UNË PERFAQESOHEM ME VLERAT E KOLEGJIT BIZNESI NË PUNËN TIME
(8 RESPONDENT)**


■ Nuk pajtohem ■ Pajtohem pjesërisht ■ Nuk e di ■ Pajtohem ■ Pajtohem plotësisht ■ Jam e papunë



Alumnit shprehin një vlerësim kryesisht pozitiv, me shumicën që pajtohen ose pajtohen plotësisht. Vetëm disa përgjigje neutrale ose të pjesshme tregojnë nevojën për përmirësim të vazhdueshëm në aspekte të caktuara të përvojës institucionale, ndërsa nuk ka vlerësime negative, duke reflektuar një perceptim të përgjithshëm të kënaqshëm.

**8. MBAHEM I INFORMUAR PËR ZHVILLIMET E VAZHDESHME NË
KOLEGJ (SHPLLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE, KONFERENCA, NGJARJE,
SEMINARE, TRAJNIME DHE LIGJËRATA PUBLIKE ME QËLLIM TË
AVANCIMIT PROFESIONAL (8 RESPONDENT)**

■ Nuk pajtohem ■ Pajtohem pjesërisht ■ Nuk e di ■ Pajtohem ■ Pajtohem plotësisht ■ Jam e paunë




Alumnit shprehin një nivel të lartë kënaqësie lidhur me informimin dhe komunikimin institucional të Kolegjit Biznesi, sidomos për zhvillimet e vazhdueshme si shpalljet për vende të lira pune, konferencat, ngjarjet, seminarët, trajnimet dhe ligjëratat publike me qëllim avancimin

profesional. Shumica e respondentëve pajtohen ose pajtohen plotësisht me këtë aspekt. Megjithatë, disa vlerësime të kufizuara dhe përgjigje neutrale tregojnë nevojën për ruajtjen dhe përshtatjen e vazhdueshme të kanaleve të komunikimit me alumnit, për të siguruar lidhje më të mirë dhe informim efektiv.

10. PËRSHTYPJET TUAJA PËR KOLEGJIN BIZNESI SI INSTITUCION I ARSIMIT TË LARTË (8 RESPONENT)


■ Shum i/e pakënaqur ■ Shum i/e kënaqur ■ I/E kënaqur
 ■ Jam ndar shumë e kënaqur ■ Nuk kam njohuri ■ Mesatarisht e kënaqur




Alumnit shprehin një perceptim përgjithësisht shumë pozitiv ndaj Kolegjit Biznesi si institucion i arsimit të lartë. Shumica janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me përvojën e tyre institucionale, ndërsa disa vlerësime neutrale tregojnë nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të përvojës institucionale dhe cilësisë së shërbimeve.

11.INKURAJOHET TË ZHVILLOJ BASHKËPUNIMIN E KOLEGJIT BIZNESI ME NDËRMARRJEN APO INSTITUCIONIN NË TË CILIN JAM I ANGAZHUAR (8 RESPONENT)

■ Nuk pajtohem ■ Pajtohem pjesërisht ■ Nuk e di ■ Pajtohem ■ Pajtohem plotësisht



Alumnit vlerësojnë shumë pozitivisht inkurajimin për zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet Kolegjit Biznesi dhe institucioneve apo ndërmarrjeve ku janë të angazhuar. Megjithatë, disa vlerësime neutrale ose të pjesshme tregojnë nevojën për forcimin e mëtejshëm të mekanizmave që mbështesin këtë bashkëpunim institucional.



Alumnit shprehin një nivel shumë të lartë gatishmërie për ta rekomanduar Kolegjin Biznesi si institucion të arsimit të lartë, ndërsa disa vlerësime më të rezervuara tregojnë nevojën për ruajtjen dhe forcimin e vazhdueshëm të reputacionit institucional.

3.Përmbledhje e Gjetjeve Kryesore nga Pyetësi me Alumnit

Rezultatet tregojnë se alumnit e Kolegjit Biznesi shprehin një perceptim përgjithësisht shumë pozitiv për përvojën e tyre gjatë studimeve. Ata vlerësojnë veçanërisht zhvillimin e aftësive analitike dhe logjike, autonominë në të nxënë, aplikueshmërinë praktike të njohurive dhe shkathtësive të fituara, si dhe relevancën e plan-programëve dhe lëndëve zgjedhore me nevojat profesionale dhe kërkesat e tregut të punës.

Alumnit shprehin identifikim të lartë me vlerat institucionale të Kolegjit Biznesi, kënaqësi me komunikimin dhe informimin institucional, gatishmëri për bashkëpunim me institucione dhe ndërmarrje, si dhe një interes të fortë për rrjetëzim dhe ruajtjen e lidhjeve me kolegët. Ata gjithashtu tregojnë gatishmëri të lartë për të rekomanduar Kolegjin Biznesi te të tjerët.

Megjithatë, disa vlerësime neutrale ose më të rezervuara evidentojnë nevojën për përmirësime të vazhdueshme, duke përfshirë forcimin e komponentëve praktikë të studimeve, rritjen e përfshirjes së alumnive në aktivitetet institucionale, përmirësimin e mekanizmave të bashkëpunimit dhe rrjetëzimit, si dhe ruajtjen dhe forcimin e reputacionit institucional.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një nivel të lartë kënaqësie dhe përvojë pozitive të alumnit, duke identifikuar njëkohësisht fushat ku institucionit mund të ndërmarë masa për zhvillim të mëtejshëm të cilësisë dhe relevancës së programeve studimore.

Rekomandime

1. Marrja e feedback-ut nga alumnit:

Pyetja e alumneve për mendimet e tyre mbi lëndët dhe përvojën akademike për të përmirësuar programet.

2. Te vazhdohet te Informohen rregullisht:

Dërgimi i njoftimeve për seminare, trajnime, konferenca dhe mundësi bashkëpunimi me alumnit.

3. Te vazhdohet me Angazhimin e alumneve:

Organizimi i takimeve ose ligjëratave ku alumnit mund të ndajnë përvojat dhe të mbështesin studentët aktualë.

Zbatimi i këtyre rekomandimeve pritet të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të përvojës akademike, rritjen e relevancës profesionale të programeve studimore dhe thellimin e marrëdhënieve funksionale ndërmjet Kolegjit Biznesi dhe alumneve të tij.